

Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Kuvendi Komunal-Junik

Nr. 01-01/22

Datë: 16. 05. 2022, ora 15⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbi Mbledhjen e Parë e Rregullt e të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur më datën 16 Maj, 2022, në orën 15⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Këshilli si në vijim:

1. Ruzhdi Shehu-Kryetar i Komunës - Kryesues i KKSB-së,
2. Rasim Sylja- Komandant i Stacionit Policor në Junik,
3. Imer Krasniqi – Përfaqësues i Bashkësisë Islame,
4. Zejnepe Gaxherri – Kryesuese e Komitetit për Komunitete,
5. Xhevahire Krasniqi – Zyrtare për Barazi Gjinore,
6. Xhavit Velijaj – Drejtor i drejtorisë për Arsim, Kulture, Rini dhe Sport,
7. Xhavit Gaxherri -Kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës së Junikut,
8. Arbër Gjota – Përfaqësues i Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi,
9. Shkëlzen Shehu – Përfaqësues i Emergjencave Civile Komunale,
10. Dukagjin Lllolluni – Përfaqësues nga OJQ,
11. Arsim Shehu – Përfaqësues nga Komuniteti i Biznesit, dhe
12. Qamil Jasiqi– Përfaqësues nga Komuniteti i Personave me Aftësi të Kufizuara.

Në këtë mbledhje munguan; Dervish Avni Muslijaj-“Teqja e Madhe Amë e Tarikatit Alijjei-Haletije Xhaferi”, Junik, Albestrim Rexhepi - Përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Afërdita Shehu - Kryesuese e Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, dhe Leonita Jasiqi - Përfaqësuese e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Mbledhjen e Parë të Rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022, e shpalli të hapur kryesuesi i KKSB-së z. Ruzhdi Shehu, i cili përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje dhe nga anëtarët Këshillit kërkoj miratimin e Rendit të Ditës si më poshtë:

1. Konstituimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi,
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut, dhe
3. Të ndryshme.

Ky Rend i Ditës u miratua nga anëtarët e pranishëm në këtë mbledhje të KKSBB-së.

**Pika e parë të Rendit të Ditës,
*Konstituimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.***

Kryesuesi z. Ruzhdi Shehu tha, unë kam emëruar Nënkryetarin e Komunës z. Besart Tofaj si koordinator të KKSBB-së. Këtë Këshill e kemi formuar në bazë të udhëzimeve, dhe në radhë të parë unë kërkoj që paraprakisht të jemi të vetëdijshëm që komunikimet e brendshme të mos komunikohen apo interpretohen jashtë, sepse kjo është një kulturë që duhet ta ruajmë brendapërbrenda KKSBB-së, dhe mendoj se ky është një Këshill me rëndësi të veçantë.

**Pika e dytë e Rendit të Ditës,
*Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut***

Z. Ruzhdi Shehu tha, unë konsideroj se siguria në Komunën e Junikut është në interes të të gjithë akterëve dhe qytetarëve të Junikut, ndërsa fjalën ia kaloj Komandantit të Policisë në Junik, z. Rasim Sylja.

Z. Rasim Sylja tha, gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut në përgjithësi është e qetë dhe stabile. Gjithsejtë i kemi pasur tri raste të veprave penale dhe tri aksidente, të cilat në asnjë mënyrë nuk e prishin imazhin as të sigurisë, as të policisë. Terreni është i mbuluar 24 orë. Kemi bërë disa projekte siç janë; parandalimi i grabitjeve, vjedhjeve, parandalimi i aksidenteve, rregullimi i komunikacionit, parandalimi i zjarreve dhe zjarr-vënies, parandalimi i vjedhjeve të pyjeve dhe disa projekte tjera që janë aktive ose joaktive, varësisht nga situata në terren që mundet të na shfaqet.

Pak e kemi problem rregullimin e komunikacionit për shkak të hapësirave të vogla, por kjo nuk është edhe aq shqetësuese, por po mundohemi të bëjmë më të mirën. Si shkak është vet konfiguracioni i rrugëve dhe gjerave tjera e bëjnë Junikun që të duket pak më ndryshe. Gjatë këtij viti i kemi pasur 280 patrullime me veturë, 351 patrullime këmbë, 649 pika kontrolli. Për kundërvajtje të ndryshme janë dhënë 242 tiketa. Në përgjithësi është bërë punë e mirë në parandalim dhe mbulim të terrenit. Ne si polici jemi për bashkëpunim të mirë me juve si Komunë dhe me institucionet tjera, si me KKSBB-në, Këshillin Lokal për Siguri në Bashkësi, dhe me të gjithë të tjerët që lidhen me sigurinë e qytetarëve të Komunës së Junikut.

Kryetari z. Ruzhdi Shehu falënderoj Komandantin e Policisë z. Rasim Sylja dhe tha, neve duhet të jemi pjesë e ndihmës për sigurinë e qytetarëve pa hezitim, më mirë të marrim masa parandaluese sesa të ballafaqohemi me pasojat, shtoj ai.

ijetër, kemi probleme me çështjen e parkingjeve në Komunën e Junikut, që janë të pamjaftueshme, mirëpo do të përpjekemi që bëjmë një zgjidhje e cila nuk do të jetë e shpejtë, por ndoshta do të kemi mundësi që ta rregullojmë këtë çështje. Propozimet janë të mirëseardhura nga ana juve për bashkëpunim në parandalimin e dukurive negative, së bashku me komunitetin fetarë, shoqëritë civile, bizneset e të tjera.

Rreth kësaj pike fjalën e mori edhe z. Xhavit Velijaj- Drejtori i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini e Sport, i cili diskutoj rreth sigurisë në komunikacion, dhe kërkoj nga Komandanti i Policisë që të identifikohen disa pika që janë shumë të ndjeshme, ku veturat lëvizin me shpejtësi shumë të madhe. Neve na duhet një bashkëpunim i të gjithëve, ne mënyrë që të largojmë rrezikun, shtoj ai.


Pika e tretë e Rendit të Ditës, Të ndryshme

Për këtë pikë të Rendit të Ditës fjalën e kërkoj z. Xhavit Gaxherri i cili ngriti çështjen e trotuareve dhe çështjen e sigurisë në komunikacion në Komunën e Junikut, dhe kërkoj që trotuaret të jenë të lira për këmbësorët dhe qytetarët, pra t'u shërbejnë qytetarëve, dhe kjo të bëhet në bashkëpunim edhe me policinë.


Z. Xhavit Gaxherri poashtu tha se të njëjtën çështje në mbledhjen e kaluar e kishte ngritur edhe z. Qamil Jasiqi, i cili kishte theksuar se ai ka problem në qasjen të bizneset dhe lokalet të tij në lagjen Qendër në Junik, ku automjetet e qytetarëve parkohen në trotuar dhe në vend-parkingjet e lokaleve të tij. Z. Qamil Jasiqi ka kërkuar që nga policia të merren masa lidhur me rregullimin dhe sanimin e këtij problemi.

Me kaq, kryesuesi, z. Ruzhi Shehu shpalli të mbyllur këtë mbledhje të KKSBS-së.

Procesmbajtësi,


Gëzim Geci

Kryetari i Komunës, Kryesues i KKSBS-së


Ruzhi Shehu